



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 204 prot.

Pukë, më 02.02 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 02 datë 02.02.2026

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” (PAS VDEKJES) I BASHKISË
PUKË

Z. PAL KOL LLESHI

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa “m”; ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, Keshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij me datë _____.02.2026;

Vendosi:

1. T’i akordojë titullin “QYTETAR NDERI” (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë.

Z. PAL KOL LLESHI

Me motivacionin:

Në nderim dhe vlerësim të një prej mësuesve të parë të krahinës së Pukës, i cili me përkushtim të jashtëzakonshëm dhe frymë misionari dha një kontribut të çmuar në përhapjen e dijes dhe ngritjen e arsimit në shumë fshatra të Njësisë Administrative Gjegjan dhe më gjerë, duke u shndërruar në frymëzim të brezave dhe në shembull të përhershëm të mësuesit të vërtetë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Pukë.

Paraqiten projektin;

Drejtori i Menaxhimit të BNJ.

Sokol Gjoni

Juristi

Aida Sinani

Kryetari

Rrok Dodaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 904/f prot.

Pukë, më 02.02.2026

RELACION

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” (PAS VDEKJES) Z. PAL KOL LLESHI

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Pukë

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në bazë të rregullores së Këshillit Bashkiak Pukë për dhënie e titujve të nderit dhe vlerësimeve institucionale, paraqitet për shqyrtim dhe miratim propozimi për dhënie e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) z. Pal Kol Lleshi.

Z. Pal Kol Lleshi është një prej mësuesve të parë të krahinës së Pukës, i cili me përkushtim të jashtëzakonshëm dhe frymë misionari dha një kontribut të çmuar në përhapjen e dijes dhe në ngritjen e arsimit në shumë fshatra të Njësisë Administrative Gjegjan dhe më gjerë. Veprimtaria e tij arsimore ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në luftën kundër analfabetizmit dhe në formimin arsimor e qytetar të brezave të tërë nxënësish.

Me punën, devotshmërinë dhe shembullin e tij personal, ai u shndërrua në frymëzim të brezave dhe në model të mësuesit të vërtetë, që e ushtron profesionin si mision fisnik në shërbim të komunitetit dhe shoqërisë.

Figura dhe kontributi i z. Pal Kol Lleshi gëzojnë respekt dhe vlerësim të gjerë në komunitetin e Njësisë Administrative Gjegjan dhe në të gjithë territorin e Bashkisë Pukë, duke u konsideruar pasuri e çmuar e trashëgimisë arsimore dhe shpirtërore të kësaj treve.

Për sa më sipër, vlerësojmë se z. Pal Kol Lleshi i plotëson plotësisht kriteret për dhënie e titullit “Qytetar Nderi” (pas vdekjes) dhe propozojmë miratimin e këtij titulli nga Këshilli Bashkiak Pukë, si shprehje mirënjohjeje dhe nderimi për jetën dhe veprën e tij.

Bashkëlidhur:

1. PROJEKT VENDIMI, Nr. 02, datë 02.02.2026

PËR DHËNIEN E TITULLIT ‘QYTETAR NDERI’ (PAS VDEKJES) I BASHKISË PUKË Z.PAL KOL LLESHI

2. Miratimi i Komisionit Këshillimor.

Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Sokol Gjoni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KOMISIONI KËSHILLIMOR PËR MEDALJET DHE TITUJT VENDOR TË NDERIT

Nr. 204/2 prot.

Pukë, më 07.02.2026

MIRATIM

PËR DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI" I BASHKISË PUKË

Z. PAL KOL LLESHI

(Pas vdekjes)

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 94/2022 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.861 datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", VKB nr.71, datë 27.12.2024 "Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor "Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë", si dhe VKB nr.70, datë 27.12.2024, "Për krijimin e komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendor të nderit në Bashkinë Pukë"; pasi u njohëm me materialet dhe dosjen e plotë, përmes së cilës dokumentohet roli i z. Pal Lleshi, si **"Një prej mësuesve të parë të krahinës së Pukës, i cili me përkushtim të rrallë dhe prej misionari dha një kontribut të vyer në përhapjen e dijes dhe ngritjen e arsimit në shumë fshatra të zonës. Frymëzues i brezave dhe shembull i përhershëm i mësuesit të vërtetë që ndriçoi rrugën e të tjerëve"**, shprehemi unanimisht për vlerësimin e tij të merituar nga Bashkia Pukë si "Qytetar Nderi", (pas vdekjes).

KOMISIONI KËSHILLIMOR

1. Sokol Gjoni

2. Denisa Meçi

3. Endrit Kraja

4. Rasim Laçi

5. Ylli Hadroj